

Projekti për riciklim të baterive

Ky projekt implementohet nga Qendra për Studime të Avancuara FIT dhe është financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për riciklimin e baterive të vogla.

Qëllimi ynë është që ti ndihmojmë nxënësit e shkollave fillore në Prishtinës dhe Fushë -Kosovës për të mbajtur një ambient të sigurt dhe të pastër dhe për të krijuar shprehje të mira të riciklimit të baterive. Me aktivitetet tona, ne shpresojmë të informojmë fëmijët, për rreziqet e hedhjes së mbeturinave në formë të pakontrolluar dhe të paorganizuar dhe dhënien e këshillave se si dhe ku mund të hidhen bateritë pa dëmtuar ambientin dhe në mënyrë të sigurt.

Në marrëveshje me drejtoritë e shkollave të Prishtinës dhe Fushë Kosovës Qendra FIT ka vendosë shporta speciale (të punuara enkas për grumbullimin dhe ruajtjen e baterive të harxhuara) në shkolla ku fëmijët do të mund vendosin bateritë e zbrazëta për riciklim.

Ne i inkurajojmë të gjithë nxënësit që t'i bashkëngjiten iniciativës sonë dhe të marrin pjesë në riciklimin e baterive të vogla.

Shkolla fillore e cila ka grumbulluar sasinë më të madhe të baterive do shpërblehet dhe do të pranoj mirënjohje nga Qendra FIT.

Pse t'i riciklojmë bateritë

Bateritë përmbajnë materie toksike dhe metale të rënda të cilat janë të dëmshme për ambientin dhe njerëzit. Metalet e rënda mund të përhapen përmes ajrit nëse digjen, mund të rrjedhin dhe depërtojnë në ujësjellës nëse mbulohen me dhe apo lihen në deponi dhe kështu ato helmojnë zinxhirin tonë ushqimor.

Andaj, mos i hudhni bateritë e zbrazëta në mbeturina. Duke ricikluar bateritë e zbrazëta ne përmbushim standardet e Bashkimit Evropian dhe e bëjmë vendin tonë një ambient të shëndoshë për ne dhe gjeneratat e ardhshme.

Riciklimi i baterive po ashtu...

- * Kursen pasuritë natyrore
- * Kursen energjinë
- * Zvogëlon ndotjen e ambientit
- * Zvogëlon shpenzimet

Si mund të kontriboni edhe ju?

- * Bëhuni pjesë e faqes së **Qendra për Studime të Avancuara FIT** në Facebook
- * Bartni apo transmetoni njohuritë tuaja dhe paralajmëroni të afërmit tuaj për dëmin nga bateritë
- * Grumbulloni bateritë e harxhuara dhe vendosni në shportat speciale të vendosura në shkollat tuaja
- * Bëhuni pjesë e organizimeve për mbrojtje të ambientit, klubit të gjelbër, etj.

Projekti për riciklimin e baterive të harxhuara



Bateritë – informata thelbësore

Bateritë të cilat përdoren sot përmbajnë më pak substance të rrezikshme sesa bateritë në të kaluarën. Mirëpo, edhe tani niveli i ndotjes në mes baterive të ndryshme dallon për shkak të mungesës së njohurive shkencore dhe llojllojshmërisë së madhe të baterive. Hudhja e baterive në mbeturinat e paselektuara (mbeturinat e përgjithshme) dëmton mjedisin dhe është e ndaluar me ligj në shumë vende të botës.

Efektet e materialeve toksike

Metalet e rënda mund të kenë efekte të shumta/të rënda për shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit. Me poshtë janë treguar disa shembuj:

• Moshë dhe faza e zhvillimit

Fëmijët dhe të moshuarit janë më të ndjeshëm ndaj efekteve toksike të metaleve. Fëmijët janë të ekspozuar kryesisht ndaj metaleve toksike përmes ushqimit për shkak të masës së tyre të ulët të peshës trupore. Tek fëmijët, efektet toksike janë më të mëdha për shkak se organizmi i tyre rritet shpejt, metabolizmi i tyre është më intensiv dhe qelizat e tyre ndahen me shpejtësi. Është vërtetuar se koncentrimi i plumbit në gjakun e fetusit dhe nënës është po aq i dëmshëm sikurse tek fëmijët.

• Sistemi imunitar

Duke pasur parasysh se mercuri, ari, platinumi, kromi dhe nikeli mund të shkaktojë reaksione të mbindjeshmërisë (hipersensitivitetit), fakti se disa individë mund të jenë imun ndaj këtyre metaleve mund të jetë shumë i rëndësishëm për efektet e tyre toksike.

Në deponi, metalet e rënda kanë mundësi për t'u filtruar ngadalë në ujë, ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Në natyrë, disa lloje të metaleve të rënda mund të përqendrohen në indet e organizmave dhe të vazhdojnë rrugën e tyre në gjithë zinxhirin ushqimor. Efektet e e dëmshme shëndetësore të shkaktuara nga helmimi me metale të rënda nga kontakti i tyre me ushqim, ujë ose ajër të ndotur mund të shkaktojnë: dhimbje të kokës, parehati të barkut deri tek humbje të vetëdijes, kancer, koma, madje edhe vdekje. Problemet e ndryshme shëndetësore të shkaktuara nga këto metale varen nga përqendrimi dhe koha në të cilën një organizëm i caktuar u

FAKT: më shumë se 11 milion bateri të vogla (të telekomandave/digitronave, radiove, lodrave, MP3 dhe CD players, llampave të dorës, orëve, etj.) janë importuar në Kosovë në 3 vitet e fundit. Të gjitha këto bateri të zbrazëta janë hedhur në deponitë e mbeturinave të paselektuara dhe nuk janë ricikluar.

Kujdesi dhe siguria për fëmijë

- * Mos i prekni apo grumbulloni bateritë e mëdha (akumulatorët e veturave, etj).
- * Bateritë vendosni aty ku nuk mund të arrihen nga fëmijët e vegjël. Ndërsa bateritë e harxhuara vendosni në çantë me të cilën shkoni në shkollë dhe menjëherë i vendosni në shportat speciale të vendosura në shkollat tuaja për riciklim të baterive.
- * Këshilloni edhe të tjerët që të vendosin bateritë aty ku nuk mund të mbërrihen nga fëmijët e vegjël.
- * Asesi mos luani me bateri! Mos i lejoni fëmijët tjerë në familjen tuaj të lozin me bateri. Mos i fusni në gojë sepse janë shumë të rrezikshme dhe mund të shkaktojnë lëndime serioze.
- * Mos i dëmtoni bateritë (mos i çmontoni apo zbërtheni ato). Mos i hidhni në zjarr apo në temperatura të larta.

